



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 223/6 Prot.

Shkodër, më 27/02 /2026

**LËNDA:** Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- Vendimin Administrativ nr. 8, datë 16.02.2026 i Degës së Doganës Shkodër për subjektin FEAL MAGLIERA sh.p.k me NIPT M17023003F.

Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

Aida **DIZDARI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**  
**DEGA E DOGANËS SHKODËR**

Nr. 223/19 Prot.

Shkodër, më 16/02/2026

**V E N D I M**  
**Nr. 8, datë 16.02.2026**

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganës Shkodër, mori në shqyrtim Procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore, protokolluar me Nr.223 prot., datë 19.01.2026, të mbajtur nga grupi i punës pranë zyrës doganore Shkodër në lidhje me shoqërinë **FEAL MAGLIERIA SH.P.K, me NIPT M17023003F** me administrator Benvenuto Caprio me adresë: Rruga "Inxh.Gjovalin Gjadri", nr.pasuire 11/126, zona kadastrale 8592, Shkoder Telefon: 0699907335.

Pasi u shqyrtuan dokumentacioni i më sipër, rezulton se:

Në zbatim të nenit 192-202 dhe 210-2015 të Ligjit nr102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM Nr. 651, datë 10/11/2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor" i ndryshuar kreu 3, nenet 631-633 grupi i kontrollit pranë Degës së Doganës Shkodër ka ushtruar kontroll pranë subjektit FEAL MAGLIERIA.

Subjekti FEAL MAGLIERIA me NIPT M17023003F ka punuar me autorizimin e RPA-së nr, 26574/1 datë 06.11.2023. gjatë punës me këtë autorizim, subjekti ka sjellë rakordimet deri në muajin Prill 2025. Periudha e rieksportimit ka përfunduar me datë 05.11.2025.

Në bazë të Program Kontrollit të ushtruar me shkresë nr. 2710/2 datë 07.11.2025 grupi i punës u paraqit pranë ambienteve të subjektit dhe u konstatua që subjekti nuk zhvillonte më aktivitetin e tij pranë këtyre ambienteve pasi çdo gjë ishte e mbyllur, dhe nga vëzhgimet nga dritarja e jashtme u vu re që ambientet ishin boshatisur. U bënë foto përkatëse bashkëlidhur këtij procesverbal.

Nga të dhënat e sistemit oracle vihet re që subjekti aktualisht ka gjendje artikuj që nuk i ka dhënë akoma destinacion doganore sipas tabelës se mëposhtme:

	<b>Emërtimi</b>	<b>sasia</b>	<b>vlera</b>	<b>pesha</b>
Importe	copa për bluza/fill për qepje	11061	69343.21	3452.5
Eksporte	Bluza	4395	15946.83	1063
	<b>Sasia e mbetur</b>	<b>6666</b>	<b>53396.38</b>	<b>2389.5</b>

Nga analizimi i tabelës vihet re se subjekti sasisë prej 6666 cope me vlerë 53396.38 Euro dhe me peshë respektive 2389.5 kg nuk ishte dhënë destinacion doganor.

Subjekti nuk ka përfituar Autorizim për përjashtim nga TVSH për makineritë dhe as ka pasur makineri nën RLP.

Llogaritja e detyrimit doganor për tabelën e mësipërme:

Lënda e parë copa të prera për xhupa dhe fill për të bërë xhupa në Dav e import 5 janë shoqëruar të gjitha me Euro 1 dhe nuk kanë taksë doganore . Detyrimi doganor është TVSH 20% për produktin të cilit nuk i është dhënë destinacion doganor.

Taksë doganore 0

TVSH = 53396.38\*104=5.553.224\*20%=1.110.645

Detyrimi doganor në total është 1.110.645 lekë.

Mosdhënia nga subjekti e një destinacioni doganor ka shkaktuar mosparaqitjen ne afat të dokumentit të mbylljes së regjimit.

Me shkresë nr. 223/1prot., datë 19.01.2026 subjekti është njoftuar për procesverbalin nr. 223 datë 19.01.2026 për të cilin nuk ka marrë njoftim pasi zarfi është kthyer. Me shkresë nr. 223/2prot., datë 29.01.2026 është bërë kërkesë për shpallje publike ne QKB e cila është realizuar me ciklim nr. QKB 1698 datë 02.02.2026.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër gjen të drejtë zbatimin e nenit 250, pika 1, germa “a”, pikat 2 dhe 4; nenit 252, pika 1, germa “c”; si dhe nenit 257, pika 1, germa “b” të Ligji Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për mosrespektimin e kushtëzimeve të përcaktuara në autorizimin e RPA-së dhe mosparaqitjen e dokumentit të mbylljes së regjimit.

Ndërsa për hedhjen në konsum të mallrave të importuara me përjashtim të plotë të detyrimeve doganore, gjen të drejtë zbatimin e nenit 250, pika 1, germa “b”, pika 3; nenit 266, pika 5; si dhe nenit 268, pika 2 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

## V E N D O S I:

1. Shpalljen debitor të subjektit **FEAL MAGLIERIA me NIPT M17023003F** për shkeljen e konstatuara në autorizimin e RPA-së nr. 26574/1 date 06.11.2023 dhe penalizmi si mëposhtëm:

- detyrim doganor i shmangur	1.110.645 lekë
- <u>gjobe 3-fish i detyrimit</u>	<u>3.331.935 lekë</u>
<b>TOTALI</b>	<b>4.442.580 (katër milion e katërqind e dyzetedymijë e pesëqindetëdhjetë) lekë</b>

2. Për mos paraqitjen e dokumentit të mbylljes së regjimit të RPA-së, në kundërshtim me pikën (c), të nenit 252 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën b, pika 1, të nenit 257 të Kodit Doganor, në shumën **50.000 ( pesëdhjetëmijë) lekë**.

3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizim.

4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për pasqyrimin e këtij vendimi në sistem.

5. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

**K R Y E T A R**

**Aida DIZDARI**

Konc  
Kopj

Një: